VENDIM
Nr.731, datë 1.7.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.818, DATË 29.11.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE «PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS GOLEM TË QARKUT TË FIERIT»

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën, që i bashkëlidhet vendimit nr.818, datë 29.11.2007 të Këshillit të Ministrave, nga prona nr.243, sipërfaqja 1018 (një mijë e tetëmbëdhjetë) m^2 t'i kalojë në pronësi komunës Golem të qarkut të Fierit, si truall dhe sipërfaqe funksionale e ndërtesës, ku ushtron veprimtarinë administrative, sipas formularit nr.1 dhe planvendosjes, që i bashkëlidhen këtij vendimi.
2. Komunës Golem i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë apo t'ua japë në përdorim të tretëve.
3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Golem për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

FORMULARI PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTESHME SHTETERORE

(Per inventarizimin e Pronave te Veçanta)


Komuna Golem

Fusha e perdorimit te prones:Infrastrukture dhe Sherbim Publik

Identifikoi : Fatime Velçani (Specialiste)
(Emer,mbiemer ,pozicioni zyrtar)
Supervizoi Qazim Koçi (Pergj.i Kadastres)
(Emer ,mbiemer ,pozicioni zyrtar)
Aprovoi Beqir Sulovari Kryetar i Komunes Golem
(Emer,mbiemer ,pozicioni zyrtar,tel,firma.vula)

Nr Rend	A			B			C			
	Zona kadastrale indeksi hartes	Nr. Pasuris	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones m2	Nga Sip. Totale Sa Ndertes m2	Funksioni per te cilin perdoret prona	Institucioni/ Enti me pergjegjesi administrati	Institucion Enti perdo ues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	8571	19/1	Truall	Truall I Nderteses se Zyrave te Komunes Golem	1018 m2		Administra	K Golem	K Golem	

PLANVENDOSJE E GODINES SE KOMUNES GOLEM, SHKALLA 1:500



Sip . Objekti	380 m2
Sip . rruge + parkim	390 m2
Sip . e gjelbert	188 m2
Sip . rreth objektit	60 m2
Sip . Totale	1018 m2

PUNOI:ING.MIMOZA HAXHIU